



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 932/2/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli ne Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së rezultateve në FPR dhe atyre përfundimtare në Vendvotimet (VV) në Komunën e Prishtinës, në seancën e panelit të mbajtur me 26.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, më datën 15.11.2013, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se si rrjedhojë e publikimit të rezultateve përfundimtare të publikuara me datën 14 Nëntor 2013, nga KQZ, për zgjedhjet e kryetarëve të komunave, LVV ka krahasuar të dhënat që janë përpunuar nga QNR-ja dhe janë publikuar nga KQZ-ja, ku disa kuti të votimit nuk janë të përputhshme të dhënat e publikuara me të dhënat e FPR-ve të atyre VV. Në këtë drejtim në VV 1902e/01R, kandidati Valon Murati nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim ka 3 vota sipas FRP-së, ndërsa në rezultatet e publikuara figuron që i njëjti kandidat t'i ketë 8 vota, në VV 1919e/04R kandidati për kryetar komune Visar Arifaj nga subjekti politik Partia e Fortë i ka 5 vota sipas të dhënave në FPR, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare i ka 3 vota, në VV1920e/03R kandidati për kryetar komune Shpend Ahmet nga LVV i ka 119 vota sipas FPR-së, ndërsa në të dhënat përfundimtare i ka 120, në po të njëjtin VV 1920e/03R, kandidati i LDK-së, Isa Mustafa i ka 185 vota në FPR, ndërsa në publikimin e të dhënave përfundimtare i ka 228, në VV 1934e/01R kandidati i LDK-së sipas FPR i ka 235 ndërsa sipas të dhënave përfundimtare 237, kandidati i AKR-së sipas FPR-së i ka 29 vota ndërsa sipas të dhënave përfundimtare i ka 28 vota, kandidati i PDK-së, sipas FPR-së i ka 77 vota, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare 76, kandidati i PF-së, ka 0 vota sipas FPR-së, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare ka 1 votë.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi FPR-të nga VV, ku sipas tyre janë evidentuar dallimet në të dhënat e publikuara.

Për vërtetimin e gjendjes faktike PZAP-i, në kuptim të nenit 4.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka kërkuar përgjigje nga KQZ-ja lidhur me ankesën Anr. 932/2013 të datës 15.11.2013, më këtë rast PZAP-i, ka kërkuar materialin zgjedhor për Qendrat e Votimit QV1902E, konkretisht Vendvotimin (VV) 01R, QV1919E konkretisht VV04R, QV1920E konkretisht VV03R dhe 1934E konkretisht VV01R si më poshtë:

- Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV),
- Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR),
- Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe
- Librin e Votimit (LV).

KQZ-ja, me shkresën 1851/A-2013, është përgjigjur lidhur me ankesën në fjalë duke ofruar tërë materialin e kërkuar nga PZAP-i, për QV1902E, konkretisht VV 01R, QV1919E konkretisht VV04R, QV1920E konkretisht VV03R dhe 1934E konkretisht VV01R.

PZAP-i, bazuar në nenin 117.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), i cili përcakton se: “*Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i, shqyrton dhe heton te gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme*” nga kjo del se PZAP-i ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor për QV1902E, konkretisht VV 01R, QV1919E konkretisht VV04R, QV1920E konkretisht VV03R dhe 1934E konkretisht VV01R dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës si dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë e tyre reciproke si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Duke vepruar edhe sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga Aktgjykimi i saj AA nr. 8853/2013 të datës 22.11.2013, PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore se ka mospërputhje të rezultateve në QV1902E, konkretisht VV 01R, QV1919E konkretisht VV04R, QV1920E konkretisht VV03R dhe 1934E konkretisht VV01R, mes të atyre të publikuara më herët dhe rezultateve përfundimtare është e mundshme, sepse rezultatet preliminare janë fleksibile dhe të ndryshueshme në çdo moment, që nënkupton se këto rezultate publikohen për pa u proceduar të gjitha fletëvotimet. Ndërsa rezultati përfundimtar është publikuar me 14.11.2013, nga KQZ-ja, të cilat rezultate publikohen pas procedimit të gjitha fletëvotimeve.

Për me tepër rezultatin e potencuar në ankesë e ndryshojnë edhe votat me kusht, votat e votuesve me nevoja të veçanta dhe votat nga diaspora, të cilat vota nuk janë të paraqitura në FPR. Nga kjo del se rezultatet në FPR mund të ndryshojnë me rezultatet përfundimtare ngase votat e votuesve me nevoja të veçanta, votat me kusht dhe votat nga diaspora nuk janë të paraqitura në FPR, por ato vota administrohen dhe numërohen direkt në Qendrën e Numërimit dhe te Rezultateve (QNR), dhe pas administrimit të te gjitha fletëvotimeve publikohen rezultatet përfundimtare, andaj edhe ekzistojnë ndryshimet te numrit të votave të theksuara në ankesë.

Prandaj nga te gjitha arsyet e sipërshënuara PZAP-i bazuar në nenin 118.1 të LZP-së i cili parasheh se: “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*” lidhur me nenin 115.1 të LZP-së i cili përcakton se: “*PZAP-i është organ i përhershëm i pavarur kompetent për te vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me ligj dhe me rregulla zgjedhore*”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 932/2/2013 më datën 26.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.